

**REALIZMI SOCIALIST  
LIBERALIZMI DHE FORMALIZMI****Artet pamore**

**Fjalë kyçe:** socializmi, shqiptarët, arti, Shqipëria, Enver Hoxha, Edison Gjergo, etj.

**Ardian Isufi****Universiteti i Arteve-Tiranë. Fakulteti i Arteve të Bukura.****Abstract**

Enver Hoxha në vitet '60 kritikonte shtëpitë e kulturës pse kishin më shumë fizarmonika, kitara, mandolina në vend që të kishin më shumë defe, gërneta, fyej, lahuta, e këto të ishin të shpërndara edhe të banorët e fshatrave të Shqipërisë. Pse Hoxha frikej nga këto instrumente? Ai mendonte se instrumentet e reja sjellin frymën perëndimore në Shqipërinë Socialiste. Instrumentet e reja kishin përhapur këngët moderne. Ai e ndjente dhe e dinte se kitara dhe mandolina do bënte që të shkëputej nga këngët popullore, pasi tingujt që ato prodhojnë kanë tendencë moderne, por nëse kjo do ndodhte për Hoxhën, për artistët e këtyre shtëpive të kulturës do ishte një gabim i madh në filozofinë e strukturës së realizmit socialist në Shqipëri. Kitara do sillte një stil të ri të kërcimit, siç ishin danset evropiane, që sipas Hoxhës nëse ato do kërcesheshin në masë do të ishte një gabim tepër i rëndë dhe i madh. Mbi të gjitha Enver Hoxha kishte frikën e përhapjes së këtyre tendencave të reja moderne në koret e mëdha, e më pas ato për hapeshin si farë hithrash dhe ato mbinin kudo, pas pasur mundësi që të ia heq më rrënjët. Baleti që kishte në fokus valsën, nuk duhet të vihet në skenë, pasi sipas konceptit të realizmit socialist nuk sjell dobi në edukimin e masave. Në lidhje me eksperiencat e huaja botërore porosiste Hoxha - duhet të kemi kujdes, sidomos në fushën e letërsisë, të muzikës, të arteve figurative, të teatrit dhe të kinematografisë.

Në vitet '60 anët e errëta që pushteti i kohës sulmoi ishin si: imperializmi amerikan, borgjezia reaksionare dhe revizionistët modernë, me hrushovianët e titistët, të cilët sipas mendimit të Enver Hoxhës ishin në aleancë me njëri-tjetrin, ku po sulmojnë me tërbim vendet socialiste, ideologjinë marksiste-leniniste dhe popujt e botës që luftojnë për liri.

Sipas realizmit socialist ky imperializëm amerikan dhe revizionistët modernë, janë të zotë për të përdorur të gjitha mjetet e tyre të propagandës për të bërë të mundur hutimin e mendjeve të njerëzve, për të ua dobësuar nervat dhe vullnetin dhe mbi të gjitha për të ua errësuar ndërgjegjen e pastër të të gjithë njerëzve të cilët ishin të edukuar sipas parimeve të sistemit komunist. Imperializmi amerikan kërkonte të degjeneronte të gjitha vendet socialiste, nga ana politike, ideologjike dhe morale, me qëllimin e shtypjes dhe të shfrytëzimit të përhershëm.

Atëherë cila ishte taktika që Enver Hoxha ndoqi për ndërtimin e socializmit në Shqipëri?

Partia-shtet më në krye Hoxhën do të ndërmerre përforcimin e realizmit socialist në dy forma. Në formën e jashtme dhe në formën e brendshme. Për forcimin e realizmit socialist në formën e jashtme, Partia e Punës së Shqipërisë ndoqi taktikën e mbrojtës së marksizëm-leninizmit, në luftën e imperializmit agresor sipas tij, ku imperializmi amerikan dhe revizionistët modernë ishin më të rrezikshëm.

Forma e brendshme ishte taktika e Partisë-shtet për ndërtimin me sukses të socializmit në vend dhe për promovimin e këtij suksesi kudo dhe ngado.

Në fjalimin e Enver Hoxhës më 15 mars të vitit 1973, në përfundim të diskutimeve doli si shqetësim për vendin fryma e liberalizmit. Kjo frymë kishte hyrë në tërë veprimtarinë e Radio-Televizionit. Për çështjen e festivalit të 11-të, u kritikua ashpër Todi Lubonja si një person që kishte dëmtuar rëndën vijën e Partisë, përmes këtij festivali.

*“Që në muajin qershor 1972 u bënë revizionime në programet muzikore. U hoq muzika popullore nga emisionet e mëngjesit. Shumica e diskutantëve flisnin të indinjuar për festivalin 11”.*<sup>1</sup>

Jeta e lumtur ishte në parim të forcimit të realizmit socialist, pasi kudo duhet të kishte fytyra që kullonin djersë nga puna dhe të praktikohet buzëqeshja e 13-të, pra buzëqeshja vesh më vesh. Ndërtimi i realizmit socialist duhet të ishte në përputhje më të gjitha virtytet e parimit dhe të edukimit së realizmit socialist.

Vitet 1968-1973 konsiderohen edhe si vitet e liberalizmit në Shqipëri. Po ku u shfaq ky liberalizëm, sa zgjati dhe cili ishte përfundimi i tij?

Shqiptarët dhe në veçanti artistët i “besuan” mendimit të Enver Hoxhës, që edhe arti ynë duhet të jetë në një nivel me artin bashkëkohor, se duhet të njihej edhe kultura e huaj dhe të merrej prej saj më e mira.

Hoxha me vetëdije përgatiti këtë situatë gjoja të besueshme në vend, për të provokuar haptas artistët se edhe ne jemi si të gjitha vendet e tjera. Zhvillimi i këtyre viteve lidhej edhe me frymën e re, që artistët sollën në Shqipëri. Ata besuan për herë të parë vetes së tyre, i besuan muzës dhe modeleve, që kishin parë dhe dëgjuar, i besuan krijimit të shpirtit të tyre. Por si çdo pranverë në diktaturë edhe kjo e jona nuk zgjati shumë, kur vulën e vendosi, përfundimi i festivalit të 11-të, në fund të dhjetorit të vitit 1973.

Në dosjen e akt-akuzës për piktorin Edison Gjergo, dëshmitarët e tij shprehin gjatë proceseve të tij hetimore, se në bisedat, që kishin bërë më piktorin gjatë viteve 1971-1973, sipas tyre ai paska thënë se:

*“Se art të vërtetë ka në vendet perëndimore, aty piktori është i lirë, bën çfarë të dojë, kurse këtu në vendin tonë do të bësh çfarë të thotë Partia”.*<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (Dokumente arkivore), 1969-1973*, vëllimi II, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Fondacioni Konrad Adenauer, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Tiranë, 2019, f. 283.

<sup>2</sup> Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.

Kurse në vitin 1974, një tjetër dëshmitar në lidhje me piktorin Gjergo, është shprehur:

*“Në vitin 1974 një dëshmitar thotë në restorant “Peshku”, e pyeta Edisonin, se me çfarë po merrej këto kohë dhe më tha: Po bëj një tablo që të marr pjesë në një konkurs, por është një punë të cilën po e bëj pa qejf. Do marr pjesë në një konkurs nga ndërmarrja e tekstileve dhe po e punoj jashtë dëshirës time, sepse është sipas parimeve të Partisë dhe nuk mund të paraqes çfarë të dua në të, pse duhet të bëjmë çfarë do partia, sikur këta e kuptojnë të bukurën.*

*Në këtë restorant ishte e varur një tablo dhe ai tha ja shikojë çfarë duan këta dhe qeshi me të madhe me përbuzje. Të nesërmen shkuan në studion e tij, ku na tregoi një tablo me një partizan të rrethuar të cilin nuk ia kishin pranuar në ekspozitë. Ata nuk marrin vesh dhe ke të bësh me njerëz të cilët do të hanë kokën e tyre.*

*Çfarë të them për veten time se jam piktor dhe nuk kam asnjë lekë në xhep, rroga që na jep Partia nuk ka del as për bukën e gojës. Këtë dëshmitari thotë se e ka kritikuar dhe e ka këshilluar disa herë Edison Gjergon, por ky nuk hoqi dorë nga mendimi dhe dëshira e tij”.*<sup>3</sup>

Liberalizmi në Shqipëri ishte një ëndërr e prerë në mes, kufizimi i lirisë së artistit ishte i pashoq, madje u shkua edhe deri aty, sa artistit i caktohej ora për të krijuar dhe për t’i dhënë jetën veprës së tij artistike. Kuptohet se veprat që ata do krijonin do të ishin krye këput në funksion të partisë dhe ndërtimit të së ardhmes socialiste në vend.

Por pas vitit ’73 Shqipëria u deklarua vendi më i izoluar në botë. Kjo fazë e këtij sistemi solli padyshim edhe pasojat e veta, të cilat nuk ishin të pakta. Piktori Ali Oseku në lidhje me izolimin total të Shqipërisë do shprehej kështu:

Vitet 1971-1972 u bënë të njohura si “Brezi i pranverës liberale” dhe i hapjes në koncept, në letërsi, arte, muzikë, që mori ndëshkimin politik, kur u kthye në lëvizje mendimi e ndikimi, duke filluar prej Festivalit të 11-të të Këngës në Radiotelevizion deri në Plenumin e 4-të.

Nga ky liberalizim siç duket cenoi pushtetin e Hoxhës, ky i fundit ndërmori një spastrim të të gjithë fenomeneve, të cilat i konsideronte *mish i huaj në trupin tonë*, por pa kursyer edhe shkrimtarët dhe artistët, ndër ta mund të përmendim piktorët, si: Edison Gjergo, Maks Velo, të cilët u dënuan në burgun e Spaçit, këngëtarët, si: Justina Alija, cila që pas festivalit të 11-të, iu ndalua dalja e saj në skenën shqiptare apo Françesk Radi, i cili u dërgua në Fushë-Arrës për shumë vite.

*“Shoqëria borgjeze, shfaqet në jetën shpirtërore të shoqërisë sonë, në kuptimin tonë, në letërsi e në arte, sidomos në disa fusha ku ne kemi më pak traditë, siç janë muzika e kultivuar, artet figurative etj”.*<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.

<sup>4</sup> Enver Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artin*, vep. e cit., f. 326.

Liberalizmi duhet parë si një revolucion për liberalizimin e individit, pra si revolucion subjektiv, krijues dhe i inkuadrimin të lirisë personale në krijimin e artit. Korniza e realizmit socialist ishte një metodë, e cila mbështetej në të ardhmen e socializmit e të revolucionit.

*“Arti i ri socialist lindi në luftë me artin zyrtar, reaksionar, me formalizmin në art dhe në estetikë, kundër pikëpamjeve të “artit për art”, kundër manierizmave, që nuk shprehnin gjë tjetër, veçse shkatërrimin e brendshëm të atij lloj arti, i cili kalonte çastet e fundit të jetës së vet”.*<sup>5</sup>

Jehona e këtij liberalizimi u konkretizua edhe me masa, kështu të pabindurit u futen në burg, disa u degdisen nëpër provinca ose u kthehen librat në karton. Ata që ishin më me fat, u ndalohej e drejta e botimeve.

*“Kultura, arti dhe muzika jonë duhet të përfitojnë edhe nga përvoja e kulturës, muzikës dhe e artit të huaj”*<sup>6</sup>, por ky pohim i Enver Hoxhës kishte për qëllim njohjen e armikut.

Letërsia dhe artet të cilat ishin të mbërthyera brenda kornizës së parimeve të realizmit socialist, kur pranvera e viteve ’70, bëri që këto parime të ngurta filluan disi të thyeshin, ku në letrat shqipe u ndje më së shumti. Emrat që u goditën për këtë lëvizje liberale dhe për çështjet ideologjike, ishin Todi Lubonja, drejtori i Radiotelevizionit, si dhe dramaturgu Fadil Paçrami, sekretar i komitetit të partisë së Tiranës.

Sipas Hoxhës, Lubonja dhe Paçrami ishin nxitës për shkrimtarët dhe artistët, të cilët lejuan prirje liberale, duke lejuar *“ide dhe ndikime perëndimore të depërtonin në kulturën shqiptare (lejuan pjesë teatrale më tërheqëse, transmetime të muzikës perëndimore, italiane e të Bitëllsve në radio)”*.<sup>7</sup>

Ky liberalizim ngriti në këmbë jo vetëm politikën e kohës, por edhe të gjithë kritikën, studiuesit, madje pati edhe raste, ku shkrimtarët dhe artistët bënë autokritikë, për krijimet e tyre, duke gjetur forma e mjetë për të ruajtur në fund të fundit kokën e tyre.

Todi Lubonja në librin e tij: *“Ankthi pa Fund i Lirisë”* do theksonte edhe spastrimet e artistëve dhe intelektualëve shqiptare.

*“Një nga njollat e zeza në historinë e PPSH është “spastrimi me fushata” i shumë kuadrove dhe anëtarëve të PPSH që përfunduan para skuadrave të pushkatimit ose vdiqën në burgjet e diktaturës”.*<sup>8</sup>

Këto prirje moderne të cilat kërkuan që të largojnë letërsinë dhe artin nga skena e realizmit socialist. Në debatet e mbajtura në luftën kundër këtij liberalizimi, u theksua se kjo prirje moderne, nuk ishte gjë tjetër, veçse një nga shfaqjet më të hapura të ndikimeve moderniste në letërsinë dhe

<sup>5</sup> Dalan Shaplllo, *Aspekte të zhvillimit të artit tonë të realizmit socialist në dritën e mësimeve të partisë*, në revistën: “Nëntori”, nr. 12, 1970, f.54.

<sup>6</sup> Enver Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artin*, f. 330.

<sup>7</sup> Robert Elsie, *Një fund dhe një fillim – (Vëzhgime mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare bashkëkohore)*, botuar nga Shtëpia Botuese “Globus R”, Tiranë, 1995 & Shtëpia Botuese “Buzuku”, Prishtinë, 1995, f. 10.

<sup>8</sup> Todi Lubonja, *Ankthi i pa Fund i Lirisë-Shënime*, Albinform, Tiranë, 1994, f. 266.

artin tonë, ku krahas devijimit të formës, për ta ishte një shqetësim me vetë përmbajtja. Ku varfërimi i kësaj përmbajtje, kishte të bënte në fund të fundit me shkëputjen e letërsisë dhe të artit nga jeta dhe motivet e traditës.

*“Në këtë drejtim rol negativ kanë luajtur edhe teorizimet metafizike të rruffanit politik Fadil Paçrami për gjë të tillë në mënyrë krejt formaliste dhe duke ju kundërvënë karakterit të vërtetë novator në formë e në përmbajtje të realizmit socialist”.*<sup>9</sup>

Kjo pranverë liberalizimi e ndërprerë në mes, preku artet pamore, pasi ishin infektuar nga gjaku i huaj, cilësuar kështu nga politika e kohës, nga rrymat të cilat ishin të ndaluara të praktikoheshin në artin pamor të realizmit socialist. Rrymat të cilat preken artet pamore ishin rryma e kubizmit, e përfaqësuar nga Pikaso, rryma e ekspresionizmit, rryma e simbolizmit, rryma e dadaizmit dhe rryma e surrelizmit.

*“Duhet përmendur se disa studentë të shkollës sonë të artit, duke mos kuptuar si duhet rrezikun e madh që kanë rrymat e huaja dekadente, të nxitur edhe nga ndonjë teorizim për shfrytëzimin e teknikave të rrymave moderniste, kanë eksperimentuar dhe kërkuar jashtë jetës dhe natyrës sonë në huazimin e mjeteve shprehëse të pikturës formaliste të ekspresionizmit, kubizmit, simbolizmit dhe surelizmit. Në të njëjtën kohë kjo tendencë hermetizmi është një shprehje e shëmtuar e përuljes ndaj letërsisë dhe artit borgjez”.*<sup>10</sup>

Për artet pamore kërkohej një rimodelim i tyre, por duke ndjekur vijën e Partisë, kultin e individit dhe mbi të gjitha ndërtimin e Njeriut të Ri, Njeriut të Ri të Shqipërisë Socialiste. Këto kërkesa të bëra nga zyrtarët e kohës, u paketoheshin artistëve si thirrje për zhvillimin e krijimtarisë së tyre.

*“Artet tona figurative kanë nevojë për vepra me mendime e ide të ngjeshura, ku realiteti ynë të shprehet mbi bazat e një koncepti më të gjerë poetiko-filozofik. Kjo është një kërkesë që e shtron koha dhe vetë zhvillimi i krijimtarisë”.*<sup>11</sup>

Të vijnë më konkretisht në realitetin e viteve të liberalizimit, në artet pamore.

Piktori Edison Gjergo, u cilësuar si piktori, i cili nuk bëri art politik dhe që theu rregullat e këtij arti. Ai ishte një nga piktorët e rëndësishëm shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX. Ishte i prirë drejt një pikturë më moderne, duke u larguar rregullave të realizmit socialist të kohës. Në tablotë e tij “ndryshe” edhe pse jetonte në një mjedis të imponuar nga rregullat e politikës, ai arriti të sjell një tjetër qasje në pikturën shqiptare, duke u bazuar dhe frymëzuar te modernizmi. Dhe kjo ndodhi pikërisht në vitet 1970.

<sup>9</sup> Krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë dhe artit dhe detyrat e zhvillimit të saj të mëtejshëm në dritën e orientimeve të plenumit IV të KQ të PPSH. Nga raporti i shokut Anastas Kondo, botuar në revistën “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1974, f. 36-37.

<sup>10</sup> Krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë dhe artit dhe detyrat e zhvillimit të saj të mëtejshëm në dritën e orientimeve të plenumit IV të KQ të PPSH. Nga raporti i shokut Anastas Kondo, botuar në revistën “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1974, f. 36.

<sup>11</sup> Pandi Mele, *Mbi letrarizmin në artet figurative*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1978, f. 15.

Piktori Gjergo krijoi brenda botës së tij artistike, duke tejkaluar rregullat e realizmit socialist. “Era” e një jete politike sociale më liberale, që u ndje në fillimin e viteve ’70 edhe në kulturën shqiptare, bëri që mjaft piktorë, sidomos ata të rinj, të realizohen punimet e tyre në forma artistike “novatore” për kohën.

Ky grup artistësh, ku protagonist ishte dhe piktori Edison Gjergo, nuk gjetën frymëmarrje dhe mbështetjen e duhur. Kështu që pas dy ekspozitave kombëtare të titulluara “Pranvera (1971-1972)”, u urdhërua nga pushteti komunist, dënimi i kësaj tendence novatore në art e kulturë si veprime antiligjore dhe antikombëtare.

Një pjesë e artistëve, shkrimtarëve dhe regjisorëve, u dënuan me burgime apo dhe u persekutuan, ndër ta ishte edhe piktori Edison Gjergo, i cili sidomos me veprën e fundit të ekspozuar “Epika e yjeve të mëngjesit (1971)”, do të hapte hapësirë dhe konceptime të realizimeve bashkëkohore në pikturën shqiptare.

Kjo krijimtari nga regjimi komunist i Hoxhës u etiketuan “të degjeneruara dhe me ndikime borgjezo-revizioniste”. Ngjarjet politike të viteve 1973-1974 në Shqipëri, ndikuan edhe në jetën e piktorit Edison Gjergo, pasi ai ishte ndër artistët, që u dënuan me 8 vjet burg (1974-1982) nga Gjykata, për idetë liberale dhe krijime artistike, të ndikuara nga piktura evropiane perëndimore e asaj kohe. Ky piktor duke vepruar më kundërshtim me politikën e partisë, ka bërë piktura të ndryshme me përmbajtje reaksionare.

Në akt-akuzën për piktorin Gjergo është thënë se i pandehuri pranoi para gjykatës se nuk i ka pëlqyer arti i realizmit socialist dhe prandaj ka propaganduar, duke lavdëruar piktorët reaksionarë, modernistë, Shagalin, Pikason etj. Apo edhe i pandehuri, armiqësitë e tij kundrejt realizimit socialist e ka treguar jo vetëm duke folur me persona të ndryshëm, por edhe në punimet që ka bërë.

Piktori Alush Shima ishte një piktor i ri në ato vite dhe si i tillë, tentoi dy ose tre herë të ishte pjesë e pjesëmarrjes në ekspozita. Ai u refuzua për tendencën që shfaqti drejt arteve moderniste.

*“Pikërisht në kohën, që në Shqipëri u quajt gjoja një liberalizim i arteve, unë tentova të identifikohesha si një artist me prirje artistike moderniste, meqë po ndihej një fare flladi liberal. Por në fakt ai ishte një kurth i madh për shumë e shumë artistë dhe shkrimtarë”.*<sup>12</sup>

Referuar shtypit dhe revistave të asaj kohe, shohim që kishte filluar edhe identifikimi i atyre artistëve, të cilët kishin tentuar të shkonin jashtë skemës së artit soc-realist, që ishte i pranishëm në Shqipëri. Në listën e gazetave të kohës, figuronte edhe emri i Alush Shimës.

Pas kësaj periudhe dhe dhënies fund të këtij liberalizmi të rrejshëm, piktori zgjodhi edhe shmangien nga skema e këtij lloji arti. Ai refuzoi të bërit art për pushtetin dhe socializmin. Pas plenumit të 4-të piktori shqiptar Alush Shima e deri në vitet 1990, bëri art vetëm brenda mureve të

<sup>12</sup> Intervistë me Alush Shimen-Piktor (22.12.2018).

shtëpisë së tij, në fshehtësi të plotë prej syrit të pushtetit dhe klikës komuniste të kohës, duke ia shmangur edhe pjesëmarrjes së tij nëpër ekspozita.

Për piktorin Shima tashmë jetonte në një kohë pa kohë, ku u detyrua të kursente ekzistencën e tij fizike. Në vitet e mbylljes brenda katër mureve të shtëpisë së tij, Shima arrin të realizojë rreth 5000 vizatime, grafika jo të themi grafike të mirëfilltë, por vizatime me bojkina dhe pene, ndonjë me pasteles apo akuareli. Dhe vetëm pas rënies së sistemit komunist, ai erdhi para publikut si fenomen për artin shqiptar, ku përmes ekspozitave të tij.

Pikturat e realizuara pas vitit 1973, kishin si tematikë jetën e përditshme. Ato piktura ishin biografia e jetës që jetoi. Një jetesë mes frikës dhe dhimbjes, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në jetën tonë të përditshme dhe në jetën artistike. Vetë Shima në një ndër ekspozitat e viteve të fundit, më titull: “Territore të vogla lirie”, do shprehët: “E quaj vetën një kasafortë të mbyllur, pasi isha vetëm me veten dhe me artin tim aty brenda, jashtë nuk flisja asnjë fjalë të vetme”.

Në pikturat dhe sidomos në grafikët e tij, Alush Shima, jep mesazhet më të forta për sistemin, duke sjellë në krijimtarinë e tij artistike, anët e tij më të errëta, dhunën. Ai sistem bënte të mundur të asgjësonte njeriun. Për të dhënë botën e errët të sistemit të kohës, i vinin në ndihmë ngjyrat bardhë e zi.

*“Dritëro Agolli ishte mësuar me goditje. Në vitin 1965, një plenum i posaçëm i komitetit qendror të partisë së punës për letërsinë dhe artet, e kishte kritikuar në raportin kryesor librin e tij “Zhurma e erërave të dikurshme”, i cili pastaj u hoq fare nga qarkullimi. Ndonëse periudha e liberalizimit në kulturë (1972-1974) e gjeti “në pozita të shëndosha” (sapo kishte botuar poemën “Baballarët”, që evokonte lidhjen e brezave dhe jo konfliktin e tyre), romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, që botohej pjesë-pjesë në revistën “Hosteni”, u ndërpre me një telefonatë nervoze nga zyra të larta të shtetit”.*<sup>13</sup>

Në letërsi poezia: “Lidhjet e mia me natyrën”, e poetit 21 vjeçar Rudolf Marku u lexua nga Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve në Plenumin e katërt të komitetit qendror (26-28 qershor 1973). Kjo poezi u kritika për influencë moderniste dhe të huaja, kështu ndodhi edhe me poezitë e Faslli Halitit apo për poezinë: “Jetë” të Xhevahir Spahiut, ku u kritikuan për të meta ideologjike.

Libri poetik: “Shokët e mi” i Rudolf Markut, u hoq nga qarkullimi dhe u dërgua për karton. Vetë autori u dërgua mësues, nëpër fshatra. Po ashtu romani i Petro Markos, u hoq nga qarkullimi dhe u bë hedhja e tij në karton. Libri i Visar Zhitit do ndalohej dhe autori do futej në burg. Festivali i 11-të, të këngës në Radio-Televizion u vu në shënjestër për gabime liberale.

*“Liberalizmi” i Enver Hoxhës mund të kuptohet, përmes një poezie alegorike të poetit rumun Marin Soresku, që thotë në një poezi të veten, në kushtet e Rumanisë së Çausheskut, një i ngjashëm me Enver Hoxhën: na lejohet të kërcejmë sa të duam në garën e hedhjes së lartë, veçse tavani i dhomës, ku zhvillojmë garën është 2 metër i lartë”.*<sup>14</sup>

<sup>13</sup> Shaban Sinani, “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, f. 47-48.

<sup>14</sup> Intervsitë me Rudolf Markun-Shkrimtar. (09.03.2018).

Kritika e fortë e ardhur nga mbajtja e Plenumit e 4-t të Komitetit Qendror të Partisë (1973), kundër disa shfaqjeve të largimit nga tradita kombëtare dhe fryma popullore, shërbeu si një mësim për krijuesit, tekst shkruarit, kompozitorët dhe këngëtarët. Në përfundim të fazës së liberalizimit, iu kushtuar një rëndësi e veçantë partishmërisë proletare dhe fizionomisë kombëtare e popullore.

Arti shqiptar tashmë iu nënshtrua plotësisht parimeve të soc-realizmit, ku kompozitorë, artistë, trupa profesionistësh, u aktivizuan në ansamble vokale e instrumentale, në kore dhe orkestra frymore e simfonike, në koncertet e estradave, në shfaqjet për fëmijë, në grupet folklorike, duke ndjekur parimet e realizmit socialist, në forcimin e vijës së Partisë, në kristalizimin e Njeriut të Ri Socialist, në propagandimin e vlerave të muzikës popullore e të kultivuar, duke bërë të mundur rritjen e vigjilencës së artistëve dhe duke ndikuar në edukimin e masave punonjëse.

*“Ish -mësuesit e mi, që tashmë i kisha kolegë, më luteshin që të përgatisja materialin e analizës për kulturën, pasi ata nuk kishin njohuri për këtë sektor, madje duhej të shkruaja edhe planin e detyrave për ndryshimin e gjendjes, që ajo asnjë herë nuk mund të ndryshonte, për shkak të shtresimit të mosrealizimeve që ishin krijuar në ekonomi dhe jetesë.*

*Kur u ktheva nga shkolla e lartë në fshat kisha me vete edhe një kitarë. Njerëzit e afërt dhe disa fshatarë të mi ishin të njohur me disa instrumente, që unë i mbaja gjatë pushimeve verore si mandolinën, violinën, por kitarën nuk e kishin parë.*

*Në vitet '70 të shek. XX në fshatin tonë nuk kishte askush një televizor, madje radiot u futën pas ardhjes së dritës elektrike. Kur qëllonte të vinte si ndokush nga fshati unë e merrja në dorë kitarën dhe para se të formoja ndonjë akord, e merrja si me lezet ndonjë melodi popullore, pasi kisha “frikë se më tremben” miqtë.*

*Kur luaja me akorde apo telave më tingull të ulët ato fillonin e i ngrynin vetullat, pasi me tre telat e veshur të kitarës, (re, la mi) nuk mund të pajtoheshin. Dikush më tha: qenka e mirë për ta mbush me grurë. Do ta kujtoja këtë shprehje pas pak kohësh kur një kryetar kooperative, tentoi të magazinon grurin në shtëpinë e kulturës. Duhej festuar prodhimi i grurit të ri, por duhej vajtuar ndryshimi i destinacionit të institucioneve kulturore, për faktin e dhimbshëm se për kulturën mendohej vetëm kur kishte ndonjë festë apo ngjarje politike dhe në raste festivalesh kombëtare, e cila urdhërohej nga lart.*

*Kur unë e merrja në dorë kitarën dhe rreth saj mblidheshin shumë të rinj, që ndonjëherë harronin dhe orarin e punës, sekretari i Partisë më thërret dhe më thotë: - kam dëgjuar se po bëhesh pengesë në orarin e punë së shumë të rinjve.*

*Mos harro se shokët e tu i ke në burg, për shfaqje të huaja e qëndrime liberale, prandaj kij kujdes”<sup>15</sup>.*

<sup>15</sup> Intervistë me Esat Rukën-Kompozitor. (12.02.2018).



Sipas sistemit të kohës ka raste që të rinjtë e shohin novatorizmin si një pronë të tyre. Për shkak të këtij novatorizmi, janë thyer parimet soc-realiste, duke ndërhyrë jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë. *“Pikërisht në emër të një ‘novatorizëm’ të tillë janë përligjur edhe ato krijime formaliste e moderniste në poezi, në muzikën e lehtë, në pikturë, në regjisorë, në skenografi etj”*<sup>16</sup>, Hoxha akuzon në veprat e tij edhe dy nxitësit të quajtur kështu sipas të prirjeve liberale, siç ishin: Todi Lubonja dhe Fadil Paçrami, duke vënë theksin në propagandën, që kanë luajtur letërsia dhe artet, për të përhapur frymën e liberalizimit dhe të modernizimit evropian, aq shumë të penguar në realitetin shqiptar.

*“Në letërsi dhe në arte ka patur shfaqje të liberalizimit dhe të modernizmit antiproletar, tendenca gjoja novatore për të shtrembëruar vijën, përkrahje dhe grupime nga ana e F. Paçramit dhe T. Lubonjës të një sërë elementësh liberalë dhe të deklasuar, tendenca për të përkrahur rryma dekadente në letërsi, në muzikë, në teatër, në pikturë e gjetkë”*<sup>17</sup>

Studiuesi Tonin Çobani do në një intervistë për këtë periudhë, do na rrëfejë këto ndjesi të asaj kohe: *“Vitet ’70 janë shumë interesante, pasi u ndje një farë liberalizimi. Në një ndër shfaqjet artistike në qytetin e Lezhës, mbaj mend një fenomen të cilit nuk e kam harruar edhe sot. Në këtë aktivitet artistik, një maturante, recitoi poezinë e Ndoc Gjetjes, poezinë “Puthja”. Poezia “Puthja” është poezi, që ndodhet në vëllimin e parë të Ndocit. Pse e zgjodhëm këtë poezi? E zgjodhëm këtë poezi, që puthja kjo ndjesi kaq e bukur, të mos mbetet ilegale. Ajo vajzë maturante në atë kohë recitoi para 400 veta në sallë dhe për momentin kur përfundoi së recituar për disa çaste, i gjithë publiku shtangu, pothuajse të gjithë mbajtën frymën dhe më pas e gjithë salla shpërtheu, në një duartrokitje të fuqishme dhe të gjatë si radhë ndonjëherë. Po në këtë aktivitet u këndua një këngë për herë të parë një këngë lirike, pra duke i ikur këngëve epike, që këndoheshin për vite me radhë”*.<sup>18</sup>

Pas plenumit të 4-të lufta kundër liberalizimit ishte në fokusin e punës së Partisë dhe të vetë Hoxhës. Ai kërkonte luftën kundër shfaqjeve të konservatorizmit po ashtu, e të patrikalismit, të psikologjisë mikroborgjeze dhe të mbeturinave fetare. Në luftën e të gjithave këtyre fenomeneve të quajtura “mbeturina”, sipas tij duhet të luftoheshin me forcë dhe me rritjen e lartë të vigjilencës në mendim dhe perceptim.

<sup>16</sup> Enver Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artin*, vep. e cit., f. 390.

<sup>17</sup> Enver Hoxha, *Vëllimi 51*, f. 59.

<sup>18</sup> Intervistë me Tonin Çobanin-Studiues. (15.05.2018).

Shih: Kongresi i 7-të i BRPSH-Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, f. 28. “Gjatë periudhës raportuese rinia dhe organizata e saj kanë zhvilluar një luftë të ashpër kundër shfaqjeve liberale, mbeturinave konservatore e patriarkale. Tehu i kësaj lufte u drejtua kundër shfaqjeve liberale, të cilët vazhdimisht i fryn e i nxit armiku i klasës me qëllim që t’i furtë rinisë farën e çoroditjes e të degjenerimit, që ta shkëpusë atë nga Partia dhe nga rruga e revolucionit. Pikërisht këtë synonin të bënin armiq të popullit e të Partisë Fadil Paçrami e Todi Lubonja. Ata hiqeshin si “miq” të rinisë, por në çdo veprim e mendim qenë armiq të saj të betuar, sepse ideologjia e tyre qe borgjeze e revizioniste, arti që donin t’i servirnin që dekadent e çoroditës, mënyra e jetesës që donin t’i kultivonin qe e degjeneruar dhe skllavëruese”.

*“Shoqëritë moderne marrin shkas për sulme të ideologjive të ndryshme totalitare ndaj demokracisë”.*<sup>19</sup>

Objekti i Partisë sipas tij ishte se shfaqjet e huaja dhe liberalizmi ishin në kundërshtim me ideologjinë e rendit socialist, me edukatën socialiste revolucionare. Një i ri në Shqipëri duhet të edukohej sipas idealit komunist të përcaktuar nga Enver Hoxha.

*“Ne jemi rini e pushkës dhe e librit dhe për këtë krenohemi, sepse e dimë që kështu mbrojmë dhe lulëzojmë Atdheun, veten e socializmin”.*<sup>20</sup>

Diktatura e proletariatit ishte një tjetër mburojë e sistemit socialist në vendin tonë. Ku popullit, e në veçanti rinisë, i kërkohet që ta donte diktaturën e proletariatit dhe Partinë, si sytë e ballit. Si diktatura e proletariatit dhe Partia, simbolizonin në mënyrë të drejtpërdrejtë dashurinë për Enver Hoxhën dhe nënshkrimin e tyre ndaj çdo oreksi dhe dëshirë të tij.

E thënë si kritikë ndaj imperializmit dhe borgjezisë, Hoxha harron dhe përdor termin “liri” dhe “demokraci”, por që e përdor në kontekstin pezhorativ, në atë të “demokracisë borgjeze” e cila Hoxha ishte në armiqësi të përjetshme me të. Hoxha e njohtë mirë sistemin e lirisë dhe të demokracisë dhe pikërisht ky fakt ia trazonte mendjen dhe shpirtin atij. Lufta për ta mbajtur vendin të mbyllur dhe shtetin e vetëm në botë të izoluar, nuk ishte gjë tjetër veçse frika e tij se po humbte pushtetin e tij personal. Egoja e Hoxhës tejkalonte çdo lloj egoje tjetër të liderëve në botë, qofshin këta edhe të botës komuniste.

*“Tek diktatura e proletariatit shohim të sotmen dhe të ardhshmen tonë të sigurtë, ndaj e kemi detyrë të shenjtë që, nën udhëheqjen e Partisë, të qëndrojmë gjithnjë në ballë të luftës klasore për ta forcuar e mbrojtur atë si sytë e ballit”.*<sup>21</sup>

Hoxha e kishte strategji kujtesën ndaj rolit, që kishin arti dhe letërsia në ndërtimin e realizmit socialist. Rinia sipas tij duhet të ishte lexuesja më e apasionuar e librit, spektatorja më e zellshme e filmit dhe e teatrit, frekuentuesja më e rregullt e ekspozitave dhe e galerive të artit.

## **Si përfundim**

Pra arti dhe letërsia duhet të zhvilloheshin nën udhëheqjen e Partisë, kurse për rininë ishte detyrë e organizatës, që të punonin dhe të ngjallnin interesin e rinisë për librin, muzikën, filmin, pikturën, teatrin.

Nga kush kishte frikë Enver Hoxha kur shkruante në vitin 1977, për edukimin e rinisë me ndjenjën e patriotizmit të lartë socialist, që të jetë gjithnjë e gatshme për mbrojtjen e Atdheut. Mbrojtja e Atdheut nënkuptonte mbrojtjen e pushtetit të tij personal. Parulla e Hoxhës që “Shqiptari gjithmonë ka jetuar me djersën e ballit të vet, pa i shtrirë dorën kurrkujt” - ishte notë protestë e frikës së humbjes së pushtetit të tij.

<sup>19</sup> Erih From, *Njeriu për veten e tij*, f. 57.

<sup>20</sup> Kongresi i 7-të i BRPSH - Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, 1977, f. 30.

<sup>21</sup> Kongresi i 7-të i BRPSH - Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, 1977, f. 31.

Në strukturën e realizmit socialist në vendin tonë, përforcimi i këtij sistemi duhet të bëhej tek çdo individ kudo që të ishte, të çdo fshat sado i largët të ishte nga qendra e Tiranës, ku formimi komunist të mund mbehte pas në asnjë cep të Shqipërisë së Kuqe Socialiste.

Nuk do të harronte për ta kujtuar se roli që jep një shfaqje ishte një mjet i sofistikuar për ndërtimin e njeriut të ri, pasi këto shfaqje kishin kaluar nëpër shumë filtra dhe më pas ishte parë edhe nga kinemaja e instaluar në Bllok, nga ku do i ndiqte vetë Hoxha, pastaj të kalonin për syrin dhe kënaqësinë e publikut të qytetit apo fshatit qofshin ata.

Pas Plenumit 4-të, të Komitetit Qendror të Partisë u zhvillua një luftë e përgjithshme kundër të ashtuquajturave dobësive dhe të metave, shfaqjeve të liberalizmit dhe të mungesës së vigjilencës, të shfaqura këto si: në shtypin e kohës, në botime, në emisione televizive apo edhe në mungesën e pjesëmarrjes së piktorëve më të talentuar të kohës.

Plenumi i 4-të i Komitetit Qendror kritikoi në mënyrën më të ashpër kinse disa shfaqje të dëmshme, që kishin të bënin me imitime të së huajës reaksionare, me trajtimin e shtrembër të kontradiktave të shoqërisë, me teorizime që përçmonin krijimtarinë popullore. Ky Plenum preku emra dhe vepra në të gjitha fushat, si: në letërsi, e në muzikë, në kinematografi, në teatër, në pikturë, në skulpturë, në opera dhe në balet.

Pas Plenumit 4-të në art dhe në letërsi u vendos pushteti i dhunës, i frikës dhe mendimit të lirë. Kudo përflitej se do priteshin koka dhe vendi do shihte atë që askush më parë nuk mund ta kishte imagjinuar. Frika dhe tmerrri pas Plenumit të 4-të pllakosi gjithë vendin. Artistët, shkrimtarët, intelektualët, po madje edhe njerëzit e thjeshtë, vrapuan menjëherë nëpër shtëpitë e tyre për të fshehur ndonjë libër, revistë apo roman që mund ta kishte në tavolinën e punës së shtëpisë, apo që kishte mbetur aty-këtu në mjedise të dukshme të banesës ku jetonin. Artistët u mbyllën në guaskën e tyre, kudo mos bërë qoftë edhe ndonjë bisedë për artin dhe kulturën, pasi pas këtij Plenumi u “legalizuan” më shumë së kurrë informatorët dhe spiunazhi, të cilët dukej sikur ishin pjesa më e rëndësishme e shoqërisë për kohën. Madje fenomeni i Plenumit të 4-të, shkoi deri aty sa idealet e Partisë u bënë betimi më i besuar. Mos të harrojmë betimin dhe grushtin e mbledhur “Për idealet e Partisë”, “Pasha idealet e Partisë dhe shokut Enver”.

## Bibliografia

Elsie, Robert, *Një fund dhe një fillim - (Vëzhgime mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare bashkëkohore)*, botuar nga Shtëpia Botuese “Globus R”, Tiranë, 1995 & Shtëpia Botuese “Buzuku”, Prishtinë, 1995.

Gjergo, Edison, Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.

Hoxha, Enver, *Mbi letërsinë dhe artin*, vep. e cit., f. 326.

Hoxha, Enver, *Vëllimi 51*.

Intervistë me Alush Shimen-Piktor (22.12.2018).

Intervistë me Esat Rukën-Kompozitor. (12.02.2018).

- Intervistë me Tonin Çobanin-Studiues. (15.05.2018).
- Intervistë me Rudolf Markun-Shkrimtar. (09.03.2018).
- Kondo, Anastas, *Krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë dhe artit dhe detyrat e zhvillimit të saj të mëtejshëm në dritën e orientimeve të plenumit IV të KQ të PPSH*. Nga raporti i shokut Anastas Kondo, botuar në revistën “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1974.
- Kongresi i 7-të i BRPSH - Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, 1977.
- Kongresi i 7-të i BRPSH – Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, 1977.
- Kongresi i 7-të i BRPSH-Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë.
- Lubonja, Todi, *Ankthi i pa Fund i Lirisë-Shënime*, Albinform, Tiranë, 1994.
- Mele, Pandi, *Mbi letrarizmin në artet figurative*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1978.
- Meta, Beqir, Krasniqi, Afrim, Bello, Hasan, *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (Dokumente arkivore), 1969-1973*, vëllimi II, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Fondacioni Konrad Adenauer, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Tiranë, 2019.
- Sinani, Shaban, *“Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit*, Naimi, Tiranë, 2012.
- Shaplo, Dalan, *Aspekte të zhvillimit të artit tonë të realizmit socialist në dritën e mësimave të partisë*, në revistën: “Nëntori”, nr. 12, 1970, f.54.